



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.12.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.

2. Projektligji “Për ratifikimin e ndryshimit nr. 3 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për forcimin e shtetit të së drejtës, për qeverisjen e mirë dhe për krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme””.

3. Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisna’a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Robert Bitri, Artan Gaçi, Esmeralda Shkjau, Fatmir Toçi, Artur Bushi, Besnik Baraj, Piro Kapurani, Sadri Abazi, Ervin Koçi, Namik Kopliku, Gentian Bejko, Rakip Suli, Ilir Xhakolli, Bujar Derveni, Vladimir Kosta, Ervin Buashti, Dahsamir Kamberi, Erjeta Alhysa dhe Blerina Gjylameti.

Mungojnë:

Genc Ruli, Sherefedin Shehu, Ardian Turku, Agron Duka, Besnik Dushaj, Voltana Ademi, Gjergji Papa, Helidon Bushati, Kozma Dashi, Dashamir Tahiri, Parid Cara dhe Monika Kryemadhi.

Të ftuar:

Milbana Treska – drejtoreshë e Drejtorisë së Borxhit Publik në Ministrinë e
Financave

Argita Totozani – drejtoreshë e Drejtorisë së Integritetit në Ministrinë e
Transporteve

Majlinda Gjonaj – përfaqësuese e ARRSH-së

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje të gjithëve!

Në axhendën e kësaj jave kemi disa projektligje për të diskutuar.

Ditën e sotme kemi në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisna’a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan”, si dhe projektligjin “Për ratifikimin e ndryshimit nr. 3 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për forcimin e shtetit të së drejtës, për qeverisjen e mirë dhe për krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme””.

Relatorë janë zoti Koçi dhe zoti Toçi.

Fjalën e ka zoti Toçi.

Fatmir Toçi – Bëhet fjalë për një marrëveshje që nuk është e tanishmja, por bëhet fjalë për ndryshimin nr. 3 të marrëveshjes për fondet që qeveria amerikane ka dhënë nëpërmjet USAID-it për qeverinë shqiptare me objektiv kryesor përforcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë, si dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme. Për vitet 2013-2014 ishin llogaritur mbi 16 milionë dollarë. Në këtë marrëveshje bëhet fjalë për fondet e vitit 2014 që konsistojnë në shumën e 5 mijë 224 mijë dollarëve. Pra, kërkohet që të ratifikohet kjo marrëveshje. Dihet zërat dhe fushat e programit për të cilat do të jetë kjo marrëveshje: për qeverisje më të mirë, për shoqërinë civile, për tregtinë dhe investimet, për sektorin financiar, për konkurrencën dhe mbështetjen e programit. Sigurisht që ne ju ftojmë që ta miratojmë këtë marrëveshje, që t’i hapim rrugë zbatimit të saj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Toçi!

Fjalën e ka zoti Koçi.

Ervin Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe kjo marrëveshje, në vazhdim të asaj që tha zoti Toçi, është një marrëveshje e rëndësishme. Ky është një ndryshim i rëndësishëm për shkak se fondi prej 407 milionë dollarësh, i parashikuar për ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan, shkon në 300,1 milionë dollarë, duke i kursyer buxhetit të shtetit 106,9 milionë dollarë. Arsyeja e kursimit në një shumë të konsiderueshme bëhet për shkak të uljes të komponentit “përpunime civile”. Pra,

e gjithë ulja e vlerës së projektit është në punimet civile, që është një kursim i rëndësishëm në buxhetin e shtetit. Njëkohësisht, parashikohet të ulet edhe fondi rezervë, që është në funksion të fondit të total. Fondi rezervë ulet me 5,56 milionë dollarë. Parashikohet që kjo të rregullohet duke ulur vlerën e financimit me 101 milionë dollarë, sepse nga fondi prej 100 milionë dollarësh të siguruara nga Abu Dhabi, u përdorën 50 milionë dollarë. Edhe kontributi i qeverisë, që ishte parashikuar në shumën e 84,80 milionë dollarëve, nevojitet të rregullohet, sepse këtu duhet të reflektojmë edhe kredinë që kemi marrë nga fondi i OPEC-ut prej 24, 4 milionë dollarësh, si edhe kontributin që ka dhënë qeveria shqiptare prej 7 milionë dollarësh. Në këto kushte, mendoj se ndryshimi i marrëveshjes është mjaft i rëndësishëm, sepse kursehen 106,9 milionë dollarë, të cilat do të shërbejnë nesër për investime të rëndësishme në infrastrukturë ose në fusha të tjera dhe i vijnë në ndihmë zhvillimit të ekonomisë.

Ftoj komisionin ta miratojë këtë propozim të qeverisë, pasi është një kursim shumë i madh në buxhetin e shtetit.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Koçi!

A kanë për të shtuar ndonjë gjë, që nuk u tha nga kolegët, përfaqësuesit e ministrisë? Nuk kanë.

A ka pyetje? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e marrëveshjes “Për forcimin e shtetit të së drejtës, për qeverisjen e mirë dhe për krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme. Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisna’a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna’a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan”. Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E mbyllim mbledhjen. Shihemi nesër dhe ju lutem respektoni orarin e zhvillimit të mbledhjes së komisionit!

MBLEDHJA MBYLLET